

Termt e Referencës: Ekspert për krijimin e një protokollit monitorimi për qukapikun në Parkun Kombëtar të Prespës

1. Hyrje

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, përmes Grantit PONT në Parkun Kombëtar të Prespës (PA_024) duke ndjekur planin operacional të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar në monitorimin dhe ruajtjen e specieve treguese si një komponent kyç i menaxhimit të përgjithshëm të zonës së mbrojtur së bashku me habitatet kryesore. Për të siguruar efektivitetin e përpjekjeve tona për ruajtje, ne po kërkojmë një ekspert me përvojë për të kryer një studim në lidhje me “Protokollin e monitorimit për qukapikun në Parkun Kombëtar të Prespës”.

2. Objektivat

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a. Të prodhojë një raport mbi monitorimin e qukapikut në Parkun Kombëtar të Prespës.

3. Qwillimi

Eksperti do të jetë përgjegjës për prodhimin e një protokollit monitorimi për qukapikun në Parkun Kombëtar të Prespës, që do të ndihmojë AdZM-nw e Korçës në zbatimin e protokolleve të monitorimit. Eksperti do të ofrojë 3 ditë trajnim në terren për stafin e AdZM-sw Korçë për zbatimin e protokollit.

4. Kohëzgjatja

Konsulenca pritet të fillojë më 15 korrik dhe të përfundojë më 5 shtator. Detyra do të fokusohet në Parkun Kombëtar të Prespës.

5. Raportimi

Eksperti pritet të dorëzojë një raport dhe rekomandimet përkatëse për protokollin e monitorimit të qukapikut.

6. Kualifikimet

Kandidati duhet të ketë:

- a. 10 vite përvojë në fushën e ekspertizës së biodiversitetit
- b. Ekspertizë të dëshmuar në përbërjen e habitatit dhe specieve të Parkut Kombëtar të Prespës
- c. Njohuri me kontekstin ekologjik të zonës së projektit.

7. Buxheti

Buxheti për konsulencën referohet linjave të buxhetit:

- Aktiviteti Nr. 2.2 "Krijimi i protokolleve të monitorimit për qukapikun"

Duke bërë vlerën totale të kësaj konsulence 5080 Euro duke përfshirë 15% të taksave.

8. Procesi i Aplikimit dhe Afati

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV deri më 7 korrik në adresën info@akzm.gov.al